JOHN HODGSON

ANËTAR AKTIV I SHOQATËS ANGLO SHQIPTARE, (ANGLO – ALBANIAN ASSOCIATION)



Përgatiur nga Mal Berisha

JOHN HODGSON është anëtar aktiv i Shoqatës Anglo Shqiptare, (Anglo – Albanian Association) e cila është ende në veprimtari ne Londer, e themeluar nga koloneli Aubrey Herbert dhe Edith Durham në vitin 1912.

John Hodgson është një gjuhëtar anglez i lindur në vitin 1951. Ai ka studiuar në Universitetet Cambridge dhe Newcastle dhe ka dhënë mësim në Universitetet e Prishtinës dhe të Tiranës. Ai është përkthyesi i gjashtë veprave të Ismail Kadaresë nga gjuha shqipe në gjuhën angleze dhe I një vepre të Fatos Lubonjës.

Në vitet 1980, ai ka dhënë mësim anglisht në disa vende të Europës Lindore si në Republikën Demokratike Gjermane, Bashkimin Sovjetik dhe në Jugosllavi. Në atë kohë Këshilli Britanik (British Council) e dërgoi atë në Universitetin e Prishtinës në Kosovë. Aty ndoqi kurset verore të Gjuhës Shqipe të cilat zhvillohen edhe sot në Universitetin e Prishtinës.

Ai as që kishte ndonjë ide për Kosovën e asaj kohe, por tani pas kaq vitesh e kujton atë me shumë dashuri dhe e ka përshkruar në një libër të tij me kujtime dhe ese.

Puna e tij me gjuhën shqipe ra në sy të autoriteteve amerikane dhe e kërkuan atë që të përkthente propogandën marksiste – leniniste që përhapej në botën shqiptare.

Ai identifikohet si njëri prej dy përkthyesve i cili përkthen direkt nga gjuha shqipe në anglisht pa ndërmjetësinë e ndonjë gjuhe tjetër.

Sipas Kadaresë, thotë Hodxhson, Gjuhën Shqipe e flasin 10 milionë njerëz në tërë botën. Ai mendon se këta dhjetë milionë shqipfolës nuk janë më shumë se suedezët, qoftë në trojet e tyre qoftë nëpër botë. Por suedezët kanë një shoqatë që mbledh një numër të madh përkthyesish nga suedishtja në anglisht ndërsa përkthyes direkt nga shqipja në anglisht janë vetëm dy: Ai vetë dhe **Ani Kokobobo**.

“Duhet të bëhet shumë më tepër nga grupi anglofonë sepse kultura e duhur e përkthimit letrar varet nga të dyja palët. Nuk ka asnjë kurs diplome në gjuhën shqipe në asnjë universitet anglishtfolës për të cilin jam në dijeni që do ta nxisnin përkthimin e lëtërsisë shqipe në gjuhën angleze. Për këtë duhet bërë shumë punë edhe nga ana e shtetit shqiptar”, thotë përkthyesi.

Ai ka qenë përkthyes nga anglishtja në shqip dhe anasjelltas në Gjykatën e Krimeve të luftës në Jugosllavi, në Hagë.

Xhon Hosdxhson është një emër që i bën ndër mardhënjeve kulturore të popullit shqipëtar me botën anglishtfolëse.

Shënim: Nga njohja përsonale që kam me të kam mësuar se ai kurrë ndonjëherë nuk është sponsorizuar nga qeveria shqiptare për punën që ka bërë për kulturën tonë kombëtare.

Proud to be Albanian